

e në rrjetin  
nave

# YAHR: Gjashtëmbëdhjetë premtimet e porealizuara të Bujës

Arian Duriqi

LIPJAN, 2 KORRIK – Premtimet e kryetarit të Lipjanit, Shukri Buja, të bëra gjatë fushatës së zgjedhjeve lokale më 2009, janë vënë nën llupën e shoqërisë civile në këtë komunë, teksa sipas monitorimit shihet se 16 premtime ose 37.20 për qind janë pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e tyre. Nga evidenca që e ka plasuar të hënën Asociacioni Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR) thuhet se ka pasur gjithsej 43 premtime të dhëna nga kreu komunal gjatë fushatës, ndërsa pas atyre 16 të sipërcekura, 9 të tjera janë me shenja pozitive drejt realizimit, në 4 të tjera ka nisur procesi në realizimin e premtimit, por me ngecje. Në 3 premtime ndërkohë procesi ka filluar në rrugë të mbarë, 6 janë me hapa konkretë në realizim, derisa 5 premtime janë realizuar plotësisht. Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR duke iu referuar përmbledhjes ekzekutive që ka bërë në raportin monitorues për ekzekutivin e Lipjanit ka rekomanduar njëherësh më shumë angazhim për realizimin e premtimeve.



**Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR duke iu referuar përmbledhjes ekzekutive që ka bërë në raportin monitorues për ekzekutivin e Lipjanit ka rekomanduar njëherësh më shumë angazhim për realizimin e premtimeve**

hartuar një projekt për  
ativ, që nënkupton edhe

inave në mënyrë të organizuar, asse mbeturina ka kudo”, pohon at Rraci, drejtor i Shërbimeve mblike, sipas të cilit Komuna i ka qur disa deponi ilegale të mbe- inave gjatë muajit të kaluar, por oma ka shumë për t’u bërë në të drejtim. Edhe Rraci u bën rrje qytetarëve për marrëveshje kompaninë “Ambienti”, në nyrë që sa me shpejt të kemi një em të organizuar dhe unik për hë komunën në heqjen e mbe- inave dhe kjo do t’i kontribuonte ambienti shumë me të pastër a është tash.

raci pohon se ndotja e ambientit e shtrirja e sistemit organizativ ndër sfidat kryesore të qeveris- komunale dhe drejtorisë që ai ëheq. “Do të përpiqemi me në angazhimin tonë që të kemi ambient të pastër, por na duhet e ndihma e qytetarëve”, thotë ci. Ndotja e ambientit në këtë unë është në përmasa alar- te. Pothuajse në skaj të çdo e të rrugës dhe jashtë saj shihen turina të shkapërderdhura. Ak- sht vetëm në qytetin e Klinës një pjesë e fshatit Gremnikë të s bëhet grumbullimi i mbeturi- e në mënyrë të organizuar nga pania “Ambienti”.

“Ekzekutivi duhet të jetë më i përkushtuar që në pjesën e mbetur të mandatit të angazhohet maksimalisht në realizim premtimesh, sepse shkalla e realizimit të tyre është ajo që është”, ka thënë ai.

YAHR, ndërkaq, ka vlerësuar se në Lipjan ka probleme serioze në sferën e urbanizmit.

“Probleme ka edhe në fushën e zhvillimit urban në Komunën e Lipjanit. Në Lipjan ka ende disa zona për të cilat nuk është bërë planifikimi hapësor/urban. Probleme janë evidentuar edhe në zonat ku planet rregulluese janë miratuar, derisa problemet vijnë si rezultat i mospianifikimit të mirë dhe mosmarrjes parasysh të kushteve në terren, dhe nevojave të zonës/qytetit”, ka shtuar Krasniqi.

Për më tepër, edhe pse një komunë me një pozitë të përshtatshme gjeografike dhe me potenciale të mëdha për zhvillim ekonomik, qytetarët e Komunës së Lipjanit sipas Krasniqit përballen me të njëjtat problema sikurse pjesa tjetër e Kosovës.

“Edhe në këtë komunë brenga më e madhe e qytetarëve mbetet papunësia dhe varfëria, sepse 48.91

për qind e qytetarëve në këtë komunë janë të papunë. Kurse, 12.16 për qind e qytetarëve janë të varur nga ndihmat sociale”, ka thënë ai.

Mirëpo, përveç këtyre, telashet më specifike për komunën e Lipjanit janë edhe mungesa e ngrohtores së qytetit, kundërmimi nga ferma e pulave dhe mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike. Raporti i YAHR-it, ndërkaq, ka pasur edhe anët e veta pozitive për ekzekutivin lipjanas. Aty thuhet se në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies, që paraqesin dy prej shtyllave kryesore të funksionimit të institucioneve publike, Komuna e Lipjanit mbetet përgjithësisht e hapur për qytetarë dhe për OJQ-të.

Ndërsa, autoritetet komunale të Lipjanit duke u njohur me raportin e YAHR-it janë deklaruar të jenë të mirëseardhura këshillat dhe sugjerimet që vijnë prej shoqërisë civile, derisa kanë lënë hapësirë që premtimet megjithatë do të përmbushen në nivelin e dëshiruar. “Qëndrim i yni edhe më herët ka qenë se është herët të flitet për suksesin apo jo në përmbushje premtimesh, sepse ende ka një pjesë të të mbetur të mandatit brenda së cilës mund të ndryshojë shumëçka për të mirë. Megjithatë, ne mirëpresim këshillat dhe do të mbetemi të hapur për bashkëpunim me OJQ-të”, ka thënë Hasan Luma, shef në zyrën e informacionit publik në Lipjan.